

Uji i Gjallë

MATERIALI I SEMINARIT PËR DHIATËN E RE

Lexoji fragmentet e shkrimeve të shenjta dhe thëniet e mëposhtme, duke kërkuar ide për ujin e gjallë që ofron Jezu Krishti.

- Gjoni 4:13–14
- Gjoni 7:37–38
- 2 Nefi 9:50–51
- 3 Nefi 20:8–9

Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim:



“Uji i gjallë, për të cilin flitet te [Gjoni 4:10], është një përfaqësim i Zotit Jezu Krisht dhe i ungjillit të Tij. Dhe ashtu si uji është i nevojshëm për të mbështetur jetën fizike, po ashtu Shpëtimtari dhe doktrinat, parimet dhe ordinancat e Tij janë thelbësore për jetën e përvijimit. Ju dhe unë kemi nevojë për ujin e Tij të gjallë çdo ditë dhe në një sasi të bollshme për ta mbështetur rritjen dhe zhvillimin tonë të vazhdueshëm shpirtëror.

Shkrimet e shenjta përmbajnë fjalët e Krishtit dhe janë një rezervuar i ujit të gjallë në të cilin kemi mundësi të plotë përdorimi dhe nga i cili mund të pimë shumë dhe gjatë. Ju dhe unë duhet të shohim te Krishti dhe të vijmë tek Ai, i cili është ‘burimi i ujërave të gjalla’ (1 Nefi 11:25; krahasojeni me Ethëri 8:26; 12:28), duke i lexuar (shih Mosia 1:5), duke i studiuar (shih Doktrina e Besëlidhje 26:1), duke kërkuar në to (shih Gjoni 5:39; Alma 17:2) dhe duke u ushqyer me bollëk (shih 2 Nefi 32:3) me fjalët e Krishtit, siç përmbahen në shkrimet e shenjta. Duke vepruar kështu, ne mund të marrim drejtim dhe mbrojtje shpirtërore gjatë udhëtimit tonë në vdekshmëri.” (David A. Bednar, “A Reservoir

of Living Water” [Church Educational System fireside for young adults, 4 shkurt 2007], f. 1, broadcasts.ChurchofJesusChrist.org)

Plaku Xhozef B. Uirthlin (1917–2008), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim:



“Shumë veta ulen në tryezën e banketit të ungjillit të Jezu Krishtit dhe thjesht e cimbisin ushqimin e vendosur para tyre. Ata e ndjekin procedurën – marrin pjesë në mbledhjet e tyre ndoshta, u hedhin një sy shkrimeve të shenjta, i përsëritin lutjet familjare – por zemrat e tyre janë larg. Po të jenë të ndershëm, do të pranojnë se kanë më shumë interes për thashethemet e fundit të lagjes, aksionet e bursës dhe shfaqjet e tyre të parapëlqyera televizive sesa për mrekullitë hyjnore dhe shërbesat e këndshme të Shpirtit të Shenjtë.

A dëshironi të merrni nga ky ujë i gjallë dhe të përjetoni atë burim hyjnor që gufon brenda jush në jetë të përvijimit?

Atëherë mos kini frikë. Besoni me gjithë zemrën tuaj. Zhvilloni një besim të patundur në Birin e Perëndisë. Lejojini zemrat tuaja të drejtohen në lutjen më të zellshme. Mbusheni mendjen tuaj me dituri për Të. Braktisini dobësitë tuaja. Ecni në shenjtëri dhe harmoni me urdhërimet.” (Joseph B. Wirthlin, “The Abundant Life”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2006, f. 100)

Bazuar në atë që mësove nga studimi i këtyre burimeve, fillo të krijosh një përvijim për bisedën tënde. Sigurohu që përvijimi yt t’u përgjigjet pyetjeve vijuese. Gjithashtu mendo se si mund t’i komunikosh ndjenjat e tua për Jezu Krishtin në bisedën tënde. Merr parasysh t’i tregosh përvojat

vetjake që ke pasur me marrjen e ujit të gjallë të Shpëtimtarit dhe se si kanë ndikuar tek ty këto përvoja.

- Çfarë është uji i gjallë i ofruar nga Jezu Krishti?
- Përse na nevojitet uji i gjallë i Shpëtimtarit?
- Çfarë mund të bëjmë për të marrë ujë të gjallë nga Shpëtimtari?
- Si ndikon dijenia se Shpëtimtari dëshiron që të gjithë të marrim nga uji i Tij i gjallë në mënyrën se si ndihesh për Të?